



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. të datës 11.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët” me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. të datës 11.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët” me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 11.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët” me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Kerkese per Monitorim nr

AK- NE FTD E DOSJE SE TENDERIT TE DATES 31.07.2025 KA KERKUAR SI KRITER, PO ASHTU I NJEJTI KRITET KA QENE EDHE FTD E DOSJES SE TENDERIT TE KORIGJUAR ME DATEN 12.08.2025

2. ISO 9001-2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë. 3. Caktimi i Menaxherit të kontratës.
4. Lista e stafit profesional 4.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) të jetë i paisur me certifikat për kantier ndertimor, siguri në punë, vlersimin e ndikimit në mjedis dhe njohuri nga lamia mbrojtje nga zjarri 4.2. Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 4.3. Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektros (ose Master) 4.4. Një (1) inxhinier i diplomuar i makineris (ose Master)

NDERSA AK-SE NE FTD E DOSJES SE TENDERIT TE KORIGJUAR ME DATEN 25.08.2025 E NDRYSHON KRITERIN KOMPLET QE TI PERSHTATET KOMPANISE QE PRENTENDOJME SE JU ESHTË PARAPERGATITURE KY AKTIVITET I PROKUURIMIT

2. ISO 9001-2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë.

3. Caktimi i Menaxherit të kontratës.

4. Lista e stafit profesional

4.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) të jetë i paisur me certifikat për kantier ndertimor, siguri në punë, vlersimin e ndikimit në mjedis dhe njohuri nga lamia mbrojtje nga zjarri

4.2. Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) i certifikuar nga AME

4.3. Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektros (ose Master)

4.4. Një (1) Inxhinier i diplomuar i makineris drejtimi termooenergjetikë (ose Master

KU NDRYSHIMI I KRITERIT ESHTË NE PIKEN 4.2 – Nje inxhinieri i diplomuar i ndertimtarise konstruktiv ose master ka kerkuar shtese – i certifikuar nga AME.

Ne OE ankues konsiderojme eshte e pa arsyeshme e pa nevojshme derisa Inxhinier i Ndertimtarise-Konstruktiv e posedon Diplomen dhe Licencen.

: Kerkojme nga ana e juaj qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje pershkrimin shtese tek pika 4.2 Ku kerkohet qe Inxhinieri i Ndertimtarise-Konstruktiv te jete i certifikuar nga AME.

NDRYSHIMI I KRITERIT ne piken 4.4 – Nje Inxhinier I Makinerise drejtimi Termoenergjetike ose Master- ku ka shtuar drejtimi Termoenergjetike duke ju pershtature OE qe ju eshte parapergalliture ky aktivitet I prokurimit-

Per ne si OE eshte e pa arsyeshme dhe pa nevojshme qe patjeter te jete drejtimi Termonergjetike pasi qe ne paramase dhe parallogari nuk ekziston ndonje pozicion qe eshte parapare per tu realizuar per nxehmje qendrore.

– Kerkojme nga ana e juaj si KRPP qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje perskrimin shtese te pika 4.4 Ku kerkohet qe Inxhinier I Makinerise te jete drejtimi Termoenergjetikes.

Kerkesa per Monitorim Nr 2

NE SI OE NE KERKESEN PER SQARIME SHITESI TE DATEN 07.08.2025 KEMI KERKUAR KETO SQARIME TE POSHTE SHENUAR POR PER FAT TE KEQ NUK KEMI PRANUAR SQARIME NGA ANA E AK-SE KK PRISHTINE

SI:

KERKESE PRE SQARIME NR 1

Ju si AK-se keni kerkuar me kerkesen 4 Lista e stafit profesional si 4.1, 4.2, 4.3 4.4

Tek pershkrimi I deshmin per kerkesen 4 aq shume e keni perzi sa qe asgje nuk eshte e kuptueshme si psh 4. E gjitha lista e stafit te kerkuar ne kerkesen numer 3 nga AK duhet te kene – KU NUK KA KERKESE NR 3 POR ESHTE KERKESA NR 4.

Sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 02/2025 PËR KRITERET, KËRKESAT, RREGULLAT DHE PROCEDURAT LIDHUR ME LËSHIMIN, ADMINISTRIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCEVE PROFESIONALE PËR PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE¹

Vetem Inxhinierat e Arkitektures Licencohen me Licence A1 per trashigimi nga MKRS I cili si Inxh Arkitektures me Licence A1 nga MKRS cili eshte pergjegjes per ti mbikeqyre, menaxhuar punet ne restuarimit, konservimit, renovimit ne objekte te trashigimise kulturore.

Pyetje : A PLOTESOHEN KRITERI NR 3 DHE KRITERI NENPIKA 4.1 KRITERI NR 4. Nese ne si OE per per kriterin nr 3 caktojme Menaxher kontrate nje Inxh Arkitektures I cili posedon Licence A1 nga MKRS po ashtu I njejt ploteson edhe kerkesat e pershkruara nenpiken 4.1 te kriterit 4.

Ne si OE po ashtu konsiderojme se kerkesat qe jane e pershkruara ne kriterin 4.1 qe Inxhinier I dipl Arkitektures ose Master qe te jete I paisur me certifikat per kantier ndertimore, vleresimin e ndikimit ne mjedis jane te kota te pa arsyeshme dhe jo relevante me perskrimin e punes qe e ben nje inxhinier I Arkitektures

Kerkojme nga ana e juaj si KRPP qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje perskrimin shtese te pika 4.1 Ku kerkohet qe Inxhinier I Arkitektures te jete I certifikuar me certificate per kantier ndertimore dhe vleresimin e ndikimit te mjedisit.

Gjithashtu – Nje Inxhinieri i diplomuar i Arkitektures ose Master te jete i vlefshem per plotesimi i Kriteret nr 3 dhe 4.1 qe i njeiti Inxhinier i Arkitektures i cili kerkuar ne piken 4.1 te jete edhe Menaxher i kontrates. Eshte jo e logjikshme dhe pa arsyeshme, e pa nevoishme qe per nje aktivitet te prokurimit te kerkohen dy Inxhiniera Arkitektures.

Sipas paragrafit 1 te nenti 8 Udhhezimin Administrativ MKRS 02/2025 MKRS I LICENCON ME LICENCE A1 VETEM INXHINIERAT E DIPLOMUAR TE ARKITEKTURES OSE MASTER NE DREJTIMIN RESTUARIM DHE KONSERBVIM

PO ASHTU KOMPANIA E LICENCUAR ME LICENCI B2 GJATE EKZEKUTIMIT TE KONTRATAVE TE RESTUARIMIT DHE KONSERVIMIT DUHET TE ANGAZHOJE STAFIN E LICENCUAR, ANDAJ INXHINIERI I ARKITEKTURES ME TE CILEN ESHTË LICENCUAR KOMPANIA ME LICENCE B2 PA TJETER DUHET TE JETE MBIKEQYRES, MENAXHER GJATE IMPLEMENTIMIT TE PUNEVE NE OBJEKTE TE TRASHGIMISE.

Kerkesa per Monitorim nr 3

Ne dokumentin pergjigjen e sqarime per OE te dates 26.08.2025AK-se KK Prishtine ka pershkruar

Kerkesa per sqarim nr. 6 Kjo pike nenkupton sipas kerkeses. 11 punetoret e kualifikuar si: tekniket me shkolla te mesme, mjeshtrit e licencuar dhe shtese jane 10 punetore te tjere fizik dhe te kualifikuar me kualifikime te ndryshme sipas kerkeses. Gjithsej 21, pra sipas pikes ku jane total 20 punetore te kerkuar.

AK-se ndryshe ka sqaruar ne sqarimin per OE , por ndryshe ka pershkruar ne Dosjen e Tenderit dhe dokumentin B54 te dates 26.08.2025

Keto jane kriteret qe jane pershkruar ne FTD e dosjes se tenderit dhe B54 te dates 26.08.2025

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë se paku 20 punëtorë profesional dhe mbështetës, lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë apo punët që do t'i kryejë në projekt

5.3. Së paku 10 punëtorë në punë të ndryshme, si p.sh. shtrues pllakash, suvatues, instalues, mjeshtër kulmi, llamarin punues, saldues, etj.

5.4. Së paku 10 punëtorë fizik se paku njeri nga punetoret te kete certifikat per dhenjes e ndimes se pare, per njohuri ne menaxhimin e kantierit ndertimor, per njohuri te siguris ne pune, per perdorim te paisjeve kunder zjarrit

Nese analizojme se ne kriterin 5 jane kerkuar 20 punetore profesional dhe mbeshtetes, ne kriterin 5.3 jane kerkuar prape 10 punetoreve te ndryshem profesional mbeshtetes po ashtu ne kriterin 5.4 jane kerkuar 10 punetore fizike prape te certifikuar , kjo nenkutpon se nga ana e AK-se jane kerkuar 40 punetore. Ndersa ne pergjigjen per sqarime te dates 26.08.2025 po thote se nevojiten numri total 20 punetore te kerkuar.

KERKESË PËR KRPP : Kerkese per KRPP – Kerkojme nga ana e juaj si KRPP qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje kriterin 5.3 dhe 5.4 pasi qe eshte me se I mjaftueshem kriteri 5 qe OE ta dorezojne Listen e vulosur dhe te nenshkruar ku duhet te permbaje se paku 20 punetore profesional – Inxhinierat apo Master te kerkuar, Teknike me shkolle mesme, dhe mbeshtetes me Licence a2-1, a2-2,a2-3 si dhe Mjeshter suvatues , instalues, mjeshter kulmi, mjeshter llamrine, salldues, shtrues pllakesh etj per te ekzekutuar punet e parashikuar ne paramase dhe parallogari.

Ne si OE per piken 5.4 ku se paku njeri nga punetoret te kete certifikate per dhenjen e ndihmes se pare, per njohuri ne menaxhimin e kantierit ndertimore, per njohuri te sigurise pune, per perdorim te paisjeve kunder zjarrit kemi bere kerkese per sqarime me daten 11.08.2025 ku kemi konsideruar qe eshte e pa nevojshme e pa arsyeshme. Kemi konsideruar se kufizimi qe vetem nje l punetore ti posedoje te gjitha keto certifiakta eshte e kot, Sepse eshte e njohure kur secili punetore qe posedon Patente shofer e ka te dhene ndihmen e pare etj. OE mund te posedojne nje punetore tjeret qe ka njohuri per kontrinnier ndertimir, nje punetore tjetere me njohuri per siguri ne pune, nje punetore tjetere per perdorim te paisjeve kunder zjarrit. Por mbi gjitha eshte kriter i pa nevojshem sepse shumica e kompania posedojne punetore te trajnuar per siguri, shendet ne pune, po ashtu per mbrotje nga zjarri.

Por gjate ekzekutimit te kontrates kompania kontraktuese mund te angazhoje kompani te licencuar nga shteti qe trajnoje punetoret dhe stafin per siguri, shendet ne pune dhe mbrotje nga zjarri sipas Ligjit ne fuqi.

AK-se nuk ka ofruar pergjigje per kerkesen per sqarime te kriterit nr 5.4

KERKESË PËR KRPP Kerkese per KRPP – Kerkojme nga ana e juaj si KRPP qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje kriterin 5.4 sepse mjafton kriteri 5.

Kerkese per Monitorim nr 4

Kriteri I Kerkuar ne FTD te dates 25.08.2025

5.5. OE duhet te l pajisur me Licence B2 per zbatimin e punimeve te konservimit/restarimit te trashegemise kulturore te paluajtshme.

AK-se ne FTD te dosjes se tenderit dhe Njoftim per kontrates te dates 31.07.2025 nuk ka kerkuar qe OE te jete l Pajisur me Licence B2 te leshuar nga MKRS per zbatimin e punimeve te konservimit-restuarimit te trashigimise kulturore te paluajtshme.

Ne si OE me kerkesen per sqarim te dates 07.08.2025 e kemi informuar dhe kemi kerkuar qe si AK-se jane te obliguar qe ta respektojne Udhhezimin Administrativ MKRS nr 02/2025 ku sipas pikes 1 te paragrafit 1.3 te nenit 12 Subjektet qe mund te kryejne veprimtari restuaruese/konservuese ne objektitet e trashigimise duhet te jete te LICENCUARA sipas pikes 2.1.

Po ashtu e kemi informuar dhe kerkuar se sipas paragrafit 25.5 neni 25 Rregullores Nr 002/2025 peshkruhet qarte se OBLIGATIVE ESHTË QE LICENCEN DUHET TA POSEDOJE LIDERI NE RAST TE THEMELIMIT TE GRUPIT.

Ne si OE Albi Company duke mos u pajtuar me kriterin nr 5.7 e AK-se qe ne rast te themelimit te grupit I gjithë grupi duhet te posedoje Licencen B2 te Licencuar nga MKRS me daten 21.08.2025 Kemi kerkuar qe te eliminohet kerkese qe te posedojne Licence B2 I gjithë grupi ne rast te themelimit te grupit pasi qe eshte ne kundërshtim me paragraf 25.15 te nenit 25 Rregullores nr 002/2025 ne kundërshtim Paragrafi 4 nenit 71 LPP dhe ne kundërshtim 26.5 Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik

Kerkese per Monitorim nr 1

Ne si OE ne kerkesen per sqarime te dates 21.08.2025 kemi kerkuar sqarime dhe kemi argumentuar se jane kritere ne kundërshtim me LPP, Rregulloren

Kerkese per sqarim nr 2

5.6. Së paku 2 persona me licence A2-1: Konservues/restaurues I strukturave të Gurit ose teknik të makinerisë, te leshuar nga MKRS

A jeni ne dijeni ju si AK-se se MKRS – Ministria e Kultures nuk leshon Diploma per teknik te Makinerise

Kerkojme qe te eliminohet kriteri 5.6 se paku 2 Persona me Licence A2-1 ose teknik te Makinerise te leshuar nga MKRS pasi qe ne paramase nuk ekzistojn ndonje pozicion per pune me Gure.

Prova Ligjore: Kriteri 5.6 eshte ne kundërshtim paragrafi 1 neni 1 LPP, paragrafi 1 neni 6, paragrafi 1, paragraf 2, pika iii paragraf 6 neni 7 LPP, dhe paragrafin 3 te nenit 52 LPP pasi qe - Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës.

Pergjigjia e AK ne dokumentin Sqarimet e OE te dates 25.08.2025

Kerkesa per sqarim 2: 5.6. Se paku dy persona me licence A2-1: Nuk aprovohet kjo kerkese, kerkesa ne dosje te tenderit eshte sipas kushteve te projektit.

AK-se KK Prishtine nuk I ka marre parasyshe argumentet ligjore te LPP, Rregullores nrr 002/2024, Udhëzimin Administrativ MKRS 02/2025

KERKESA PER KRPP Kerkese per KRPP – Kerkojme nga ana e juaj si KRPP qe ta obligoni AK-se qe ta eliminoje kriterin 5.6 pasi qe se pari ne paramase dhe paralogari nuk ekziston ndonje pozicion per pune me gure, po ashtu nuk ekziston ndonje pozicion per pune makinerise. MKRS Licencon mjeshter vetem me Licence A2-1. A2-2 dhe A2-3- Metaleve, qelqit, llageve etj por nuk ekziston kategori e Licencimit per Teknik te Makinerise. Ndersa kushtet qe duhet OE te Licencohet me Licence B2 I nevojitet si staf mbështetës-mjeshter vetem nje person me Licence A2-1 dhe A2-2

Ne si OE ne kerkeson per sqarime te dates 21.08.2025 kemi kerkuar sqarime dhe kemi argumentuar se jane kritere ne kundërshtim me LPP, Rregulloren

Kerkese pe sqarim nr 3

5.9. Së paku 2 persona me licence A2-3: Konservues/restaurues I materialeve te tjera ndërtimore sipas fushes specifike te specializuar si: **per menaxhim të emergjencave, leshuar nga MKRS.**

Ju si AK ne kriterin 5.8 keni kerkuar se paku 2 persona me Licence A2-3 ndersa te njejten e keni perseriture edhe ne kriterin 5.9 ku keni kerkuar se paku 2 persona me Licence A2-3.

Pershkrimin shtese ku tek kriteri 5.9 per menaxhim te emergjencave te leshuar nga MKRS , A jeni ne lijeni si AK-se se MKRS nuk leshon Licence A2-3 per menaxhimin e emergjencave –

Sipas Udhezimit Administrativ per Licencim MKRS nr 02/2025 pika 1.2.3 nenparagrafi 1.2 – Licence A2 te paragrafit 1 te nenit 7 specifikohet qarte se si ndahen kategoria e Licencave siq jane A2-1, A2-2, A2-3 ndersa ne A2-3 ndahen metaleve,qelqit, llaceve etj.

Prova Ligjore : 1.2.3. A2-3: Konservues/Restaurues i materialeve të tjera ndërtimore sipas fushës specifike të specializuar si: metaleve, qelqit, llaceve etj.

Kerkojme qe te eliminohet kriteri 5.9 se paku 2 Persona me Lincence A2-3 sepse I njejti kriter eshte kerkuar nr 5.8.

mbi gjitha nje OE per tu Licencuar me Licence B2 nga MKRS nuk kerkohet qe te deshmoje se posedon mjeshter me Licence A2-3 sipas kritereve te paragrafit 2 te nenit 11 Udhezim Ad, MKRS nr 02/2025.

Prova Ligjore : 2. Për t'u licencuar në kategorinë B2, për zbatimin e punëve të konservimit/restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, personi juridik duhet të ketë në stafin profesional së paku këto tri kategori të licencave: 2.1. Një person me licencë profesionale A1; 2.2. Një person me licencë profesionale A2-1; 2.3. Një person me licencë profesionale A2-2.

Prova Ligjore: Kriteri 5.6 është në kundërshtim paragrafi 1 neni 1 LPP, paragrafi 1 neni 6, paragrafi 2, paragrafi 3, pika iii paragrafi 6 neni 7 LPP, dhe paragrafin 3 te nenit 52 LPP pasiqe - Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës.

Kerkesa per Monitorim nr 7

Ne si OE ne kerkesen per sqarime te dates 21.08.2025 kemi kerkuar sqarime dhe kemi argumentuar se jane kritere ne kundërshtim me LPP, Rregulloren 002/2025

Kerkesa pe sqarim nr 4

5.10. Së paku një piktor I licencuar me licencë A3-10

Kriteri nr 5.10 I cili është bere shtese ne dokument B54 te ngarkuar me dt 18.08.2025 është shtuar vetem pse ky OE te cilin pretendojme se ia kemi parapergatiture kete aktivitet te prokurimit mund te posedoje ose te marre me parakontrate.

Kerkojme qe eliminohet kriteri 5.10. Së paku një piktor I licencuar me licencë A3-10 pasi qe ne paramase nuk ekziston ndonje pozicion per pune qe duhet realizuar nga ana e ndonje PIKTORI.

Prova Ligjore: Kriteri 5.6 është ne kundërshtim paragrafi 1 neni 1 LPP, paragrafi 1 neni 6, paragrafi 1, parag 2, pika iii parag 6 neni 7 LPP, dhe pargrafin 3 te nenit 52 LPP pasi qe - **Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës.**

Pergjigjia e AK me dokumentin per Sqarime e OE ted t 25.08.2025

Kerkesa per sqarim nr. 4: Kjo kerkesa është per te kontrolluar punimet dhe ne punet restauruese duhet te jene te gatshem personeli adekuat per keto pozicione ne rast te zbulimit te pozicioneve te cilat mund te shfaqen gjate punimeve dhe është e domosdoshme konsulenca profesionale.

Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësine kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë analizuar me kujdes, dhe me këtë rast është gjetur se të gjitha korrigjimet e nevojshme në DT tanimë janë realizuar dhe kërkesat e mbetura në DT janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar projektin në mënyrë efikase dhe efektive. Po ashtu është konfirmuar se të gjitha kërkesat janë kërkesa standarde/themelore për aktivitetet e prokurimit të kësaj natyre dhe përkojnë plotësisht me qëllimin e projektit. Rrjedhimisht nuk qëndrojnë pretendimet për diskriminim apo favorizim në kuptim të nenit 6 dhe 7 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj të gjitha pretendimet ankimore janë gjetur se janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.